



REPUBLIKA E KOSOVËS/ REPUBLIKA KOSOVA/ REPUBLIC OF KOSOVO

KOMUNA E GJAKOVËS  
OPSTINA DJAKOVICA/ MUNICIPALITY OF GJAKOVA



Drejtoria për Urbanizëm dhe Mbrojtje të Mjedisit  
Nr.07/351/01-23754  
Dt. 30.11.2017

Drejtoria për Urbanizëm dhe Mbrojtje të Mjedisit duke vendosur sipas kërkesës së parashtruar nga: **Fatmir (Osman) Rexha dhe Zelfi (Smajl) Rexha** nga Gjakova, për dhënien e Lejes së Ndërtimit, për ndërtimin e objektit të kategorisë së parë, me destinim objekt i banimit individual – shtëpi familjare dyshe, me etazhitet P+1, në bazë të Ligjit për Ndërtim, Nr. 04/L-110, nenet 14, 15, 19, 20 dhe 21, si dhe Ligjit për Procedurën Administrative Nr. 05/L-031 nenit 21, 44 dhe 97 bien këtë:

## AKTVENDIM

**I. I LEJOHET:** aplikuesit: **Fatmir (Osman) Rexha dhe Zelfi (Smajl) Rexha** nga Gjakova, ndërtimi i objektit të kategorisë së parë, me destinim objekt i banimit individual – shtëpi familjare dyshe, sipas projektit kryesor të prezentuar, në përputhshmëri me Planin Zhvillimor Urban dhe Vendimin për Kushte Ndërtimore me numër 07-351/01-21891, të datës 06.11.2017, të lëshuar nga DUMM, në ngastrën kadastrale me numër 456/24, Z.K. Jahoc, në rrugën “Lekë Dukagjini”, në pronësi të lartë përmendurit, e cila ka vijën e ndërtimit dhe rregullimit të definuar dhe të prezantuar në planin e situacionit me të gjithë parametrat tjerë përcjellës për ndërtimin e objektit në fjalë, etazhiteti i objektit është P+1, me sipërfaqe të përgjithshme (bruto) të objektit  $S = 430.30 \text{ m}^2$ .

Përdhesa: (Sip,Bruto):  $S = 213.32 \text{ m}^2$   
Kati i parë: (Sip,Bruto):  $S = 216.98 \text{ m}^2$

**II.** Hartimin e projektit kryesor me destinim: ndërtimi i objektit të banimit individual – shtëpi familjare dyshe, nga pika 1 e këtij aktvendimi e ka bërë “Real – PROJECT”- Gjakovë.

**III.** Pjesë përbërëse e këtij aktvendimi është Plan Situacioni i lokacionit me objektin sipas vijës së ndërtimit dhe rregullimit, e përshkruar në situacionin grafik për të cilin është dhënë pëlqimi përkatës nga kjo drejtori i cili është bazë për rilevimin gjeodezik të objektit nga pika 1 e këtij aktvendimi.

**IV.** Investitori është i obliguar që:

- Të të ruaj një ekzemplar original të dokumentacionit teknik në bazë të të cilit i është dhënë kjo Leje Ndërtimi;
- Pa pëlqimin e hartuesit të projektit ideor dhe pëlqimin e kësaj Drejtorie, të mos bëjë asnjë ndryshim në projekt;
- Ekzekutimi i punimeve nga pika 1 e këtij Aktvendimi, të realizohet nën mbikëqyrjen e organit mbikëqyrës për realizimin e ndërtimit të objektit.
- Të lajmëroj Drejtorinë e inspektionit për ditën e fillimit të punës së paku 8(tetë) ditë para fillimit të ndërtimit, me qëllim të verifikimit dhe përcjelljes së punimeve;

**V.** Kjo Leje Ndërtimi vlen 1(një) vit nga dita e lëshimit të këtij aktvendimi.



## Arsyetim

**Fatmir (Osman) Rexha dhe Zelfi (Smajl) Rexha** nga Gjakova, me banim në rrugën "Lekë Dukagjini" pn, ka parashtruar kërkesën pranë DUMM me nr. 07/351/01-23754 të datës 29.11.2017 për dhënien e Lejes së Ndërtimit për ndërtimin e objektit të kategorisë së parë, me destinim objekt i banimit individual – shtëpi familjare dyshe, me etazhitet P+1, në ngastrën kadastrale me nr. 456/24, Z.K. Jahoc, në rrugën "Lekë Dukagjini", siç është përshkruar në pikën 1 të dispozitivit të këtij aktvendimi.

Së bashku me kërkesën investitori e ka prezantuar edhe këtë dokumentacion:

1. Planin e Situacionit në përpjesë 1:500 të datës 19.10.2017, të vërtetuar nga DUMM- Gjakovë.
2. Kopjen e planit të datës 16.10.2017 (fotokopje) në pronësi të Fatmir (Osman) Rexha dhe Zelfi (Smajl) Rexha nga Gjakova (me nga ½(pjesë ideale), të lëshuar nga Drejtoria për Kadastër Gjeodezi dhe Pronë.
3. Certifikatën mbi të drejtën në pronën e paluajtshme (fotokopje) me numër të lëndës 5675/17, të datës 18.10.2017, të lëshuara nga Drejtoria për Kadastër Gjeodezi dhe Pronë.
4. Vendimin për Kushtet Ndërtimore me numër 07-351/01-21891, të datës 06.11.2017 të lëshuar nga DUMM.
5. Aktin Noterial – Autorizim me nr. LRP. 5369/2017, dt.27.10.2017,
6. Vërtetimin mbi kryerjen e obligimeve nga tatimi në pronë, numër 430/b/815, të datës 29.11.2017.
7. Pëlqimin nga KEDS-Gjakovë, nr.1971 të datës 31.11.2017.
8. Pëlqimin nga K.R.U. "Radoniqi" Sh.A.Gjakovë, nr. 3185 të datës 20.11.2017.
9. Pëlqimin nga PTK-Gjakovë, dt. 16.11.2017.
10. Dëshminë mbi kryerjen e obligimeve nga taksa administrative dhe tarifa rregullative për rritjen e densitetit në PTK-, filiali Gjakovë, me datë 30.11.2017.
11. Projektin kryesor në 3 (tri) kopje të forta dhe 1(një) CD, i punuar nga "Real – PROJECT"- Gjakovë.

Taksa administrative dhe tarifa rregullative për rritjen e densitetit është paguar në vlerën prej 2038.74 Euro.


### KËSHILLË JURIDIKE:


Kundër këtij Aktvendimi, pala e pakënaqur ka të drejtë ankese në afatin prej 30 ditësh, duke u llogaritur nga dita e marrjes në dorëzim. Ankesa i parashtrohet Ministrisë së Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor në Prishtinë, dhe e njëjta dorëzohet nëpërmjet kësaj Drejtorie.

#### Aktvendimi i dorëzohet:

- Investitorit,
- Drejtorisë së Inspektionit,
- Arkivit.


Zyrtar i lartë për çështje juridike

  
Zenel Shabani, jur. i dipl.

  
U.D. Drejtori  
  
Elida Bejtullahu, inxh.e dipl.e ark.

K.K. GJAKOVË  
Z.K. : Gj. Jahoc  
Parc. nr. 456-24

# PLAN SITUACIONI P=1/500





# Republika e Kosovës

Republika Kosova-Republic of Kosova

Qeveria -Vlada-Government

Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor /Ministarstvo Sredine i Prostornog Planiranja/Ministry of Environment and Spatial Planning


AGJENCIA KADASTRALE E KOSOVËS/ KATASTARSKA AGENCIJA KOSOVA/ KOSOVA CADASTRAL AGENCY

## KOPJA E PLANIT / KOPIJA PLANA / COPY PLAN

Zyra Kadastrale Komunale/ Opštinska Katastarska Kancelarija /Municipal Cadastral Office : GJAKOVË

Zona Kadastrale / Katastarska Zona / Cadastral Zone: Jahoc

| Njësia/Jedinica/Unit | Tipi/Vrsta/Type            | Sipërfaqja/Povšina/Area m2 |
|----------------------|----------------------------|----------------------------|
| P-70705037-00456-24  | Pracelë / Parcela / Parcel | 500,0                      |
|                      |                            |                            |



Shkalla/Razmera/Scale: 1:500

Punoi/Obradio/Created:

Data/ Data/Date: 16.10.2017

Koha/ Vreme/ Time: 11:09:22

Nënshkrimi/Potpis/Siganture:

Shënim/Beleška/Note:

Aprovoi/Usvojio/Aproved: MCO GJAKOVË director

Nënshkrimi/Potpis/Siganture: